



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 17.07.2019

VENDIM

Nr. 38, datë 17.07.2019

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE
"MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR CIKLIN E ULËT ME DREJTIM MINOR
PARASHKOLLOR"**

Mbështetur në pikën 6 në nenin 75, shkronjën b, pika 1, në nenin 83, shkronjën dh të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën f të pikës 2 në kreun III të VKM-së nr. 31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.07.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave Humane për ndryshime në programin e ciklit të dytë të studimeve "Master profesional në mësuesi për ciklin e ulët me drejtim minor parashkollor" në përshtatje me ndryshimet ligjore që parashikojnë kalimin e këtij programi studimi nga program me 90 kredite në program me 60 kredite.
2. Programi të emërtohet "Master profesional në mësuesi për arsimin fillor kl I-V".
3. Ky program studimi do të zbatohet për vitin akademik 2019-2020.
4. MASR do të njoftohet me shkrim për ndryshimet e bëra në këtë program studimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Dr. Elenica BEQIRAJ

